AAES
Albanian Association of Electricity Suppliers

Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike

Nr. 1512/2 Prot. Tiranë, më 15/12/2025

DREJTUAR: ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE)
Z. PETRIT AHMETI
KRYETAR I BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE

Lënda: Pozicioni i Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike mbi Rregulloren për cilesine e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit ne sistemin e transmetimit te energjisë elektrike.

I nderuar Z. Ahmeti,

Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) është njohur me kërkesën për marrje mendimi të ERE dt. 21.11.2025 lidhur me fillimin e proçedurës për disa ndryshime në "Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike (Rregullorja) miratuar me vendimin e Bordit te ERE nr. 207 date 18.12.2017.
AAES vlerëson se Rregullorja duhet të adresojë më qartësisht disa nga problematikat që janë hasur në praktikë.

Një nga shqetësimet kryesore rezulton të jetë fakti që Rregullorja nuk adreson qartësisht zgjidhjet për të gjitha dëmet që potencialisht mund të shkatohen si dhe për subjektet që këto dëme mund e afektojnë. Gjithashtu, nuk ka një linjë të saktë kohor të shlyerjes/kompensimit të dëmit nga "shkaktari" i tij tek i "dëmtuari".

Më konkretisht, një mosrespektim i kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit apo performancës së sigurisë së rrjetit (ne vijim "Shkelja") mund të shkaktoj dëme ndaj furnizuesit, klientit fundor apo një pale të tretë.

Furnizuesi. Pëson një dëm i cili konsiston në pamundësinë për të blere ose shitur energjinë elektrike.

a) Disbalance e krijuar në rastet kur "Shkelja" krijon pamundësi për Furnizuesin që të marrë energjinë nga një prodhues i lidhur në rrjetin objekt të Rregullores. (Furnizuesi shkarkon/ngarkohet me disbalancë negative pasi do të furnizohet nga rrjeti për energjinë e nominuar tek Klienti Fundor të cilën nuk ka arrittur dot ta marrë nga furnizuesi).

b) Disbalance e krijuar në rastet kur "Shkelja" krijon pamundësi për Furnizuesin që të furnizojë energjinë tek Klienti fundor i lidhur në rrjetin objekt të Rregullores. (Furnizuesi shkakton disbalancë pozitive pasi energjia e nominuar prej tij nuk do të levrohet dot tek Klienti fundor por injektohet në rrjet si tepricë)

Të dy rastet më lart supozohet të trajtohen në nenin 9, pika 9.3 të Rregullores por trajtimi i tyre nuk është i qarte.
Për këtë arsye mendojmë që Rregullorja duhet të saktësojë/trajtoje specifikisht secilin prej rasteve ne menyre individuale dhe pa ekuivok.

Klienti fundor. Pëson një dëm i cili mund të konsiderohet i shumëllojshëm konsiston dhe mund të konsitojë në:

a) fitim i munguar;
b) dëmtime materiale (pajisje/makineri, zjarr etj...);
c) dëmtime në njerëz (plagosje ose vdekje).

Jemi të opinionit që Neni 10 i Rregullores ka mangësi në formulimin aktual pasi:

i. Nuk përcakton qartë se cilin nga këto dëme shpërblehet në rast të "Shkeljes". (a duhet shpërblyer i gjithë dëmi apo vetëm një pjesë e limituar e tij si për shembull vetëm dëmet materiale apo ato në njerëz).
ii. Nuk përcakton qartë që përgjegjësia e Furnizuesit për sa i takon "Shkeljes" nuk është autonome/direkte por Furnizuesi operon vetëm për të shërbyer si urë ndërlidhëse mes Operatorit te rrjetit përkatës që është përgjegjës për "Shkeljen" dhe Klientit Fundor. Për pasojë, Rregullorja duhet të përcaktojë në mënyrë pa ekuivok që Furnizuesi nuk ka asnje detyrim individual personal të pavarur për të shpërblyer apo kompensuar Klientin Fundor por vetëm për t'a asistuar atë në procedurën e kërkesës së dëmshpërblimit dhe për të transferuar dëmshpërblimin eventual nga Operatori përkatës tek Klienti.
iii. Nuk përcakton qartë rendin në të cilin duhet bërë kompensimi. Rregullorja duhet të përcaktojë pa ekuivok që Furnizuesi kompenson Klientin Fundor vetem pasi vetë Furnizuesi të jetë kompensuar nga Operatori përkatës i rrjetit.

Palët e Treta. Palët e treta kuptuar si persona/subjekte që nuk janë në marrëdhënie kontraktore as me Furnizuesin dhe as me Operatorin përkatës mund të pësojnë gjithashtu një dëm në shëndetin e tyre apo pasurinë e tyre.
Per te marrre nje shembull ilustrues, mund të permendim një humbje jete apo prone si rezultat i një zjarri të ndodhur në pronën e Klientit Fundor i cili, për shembull, përhapet tek prona fqinje; Gjithashtu, mund të permendim rastin e një shoferi/punonjësi të një subjekti tjetër i cili gjendet në ambjentet e Klientit Fundor në momentin kur ndodh "Shkelja" dhe si pasojë pëson dëme trupore ose materiale.
Rregullorja nuk adreson dëmet e Paleve të treta dhe nuk parashikon asnjë proçedurë për dëmtimet që mund ti shkaktohen kësaj kategorie subjektesh.

Në konsideratë të problematikave si më sipër, propozojmë amendimet vijuese në "Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike":

1- Në nenin 4 "Përkufizime", të shtohet përkufizimi i "Personit të Tretë".
2- Neni 9, paragrafi 9.3, të shtohet në fund një paragraf të formuluar si vijon:
"Në rastin kur Furnizuesit i shkaktohen disbalanca negative Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do t'i paguajë Furnizuesit diferencën pozitive ndërmjet çmimit të disbalancave negative të aplikuara nga OST dhe çmimit të kontratës/kontratave të Furnizimit me Klientin Fundor (në varësite të kohëzgjatjes të ndërprerjes që afekton secilën Kontratë Furnizimi në mënyrë individuale)."
3- Në nenin 10, paragrafi 10.1, në fjalinë "...OSSH do të kompensojë Furnizuesin dhe" të shtohen fjalët "më pas" përpara fjalës "ky i fundit, ...".

Gjithashtu, në këtë paragraf pas fjalëve "...do të jetë përgjegjës" të shtohen fjalët "në të njëjtën vlerë" përpara fjalëve "për kompensimin".
Propozohet që me këto shtesa paragrafi 10.1 të jetë si vijon "10.1 Bazuar në përcaktimet e "Marrëveshjes për Sigurimit të Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit", të miratuar nga Bordi i ERE, në rast të mosrespektimit të kritereve standarde të cilësisë së shërbimit sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, OSSH do të kompensojë Furnizuesin dhe më pas ky i fundit, do të jetë përgjegjës në të njëjtën vlerë për kompensimin e klientëve fundor, të cilët kanë një kontratë për furnizimin me energji elektrike me Furnizuesin."

4- Në nenin 10, paragrafi 10.3, pjesa e fundit të fjalisë "... Furnizuesi, e kompenson klientin në faturën pasardhëse të energjisë elektrike" të riformulohet si vijon "... Furnizuesi, e kompenson klientin në faturën e parë të energjisë elektrike që pason datën e marrjes së kompensimit nga OSSH."

Lutemi marrjen në konsideratë të kërkesave tona.

Ju falenderojmë paraprakisht për bashkëpunimin.

Me respekt,

SHOQATA SHQIPTARE E FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE
(AAES)

KRYETARI

Ilir SALLABI